



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

NJOFTIM

Agjencia e sigurimit të cilësisë së arsimit parauniversitar njofton të gjitha subjektet e interesuara dhe që plotësojnë kriteret e percaktuara për ankandin që do të zhvillojë për mallrat/pajisjet e nxjerra jashtë përdorimit.

Në zbatim të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 për “Menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, Ligjit Nr. 9874, date 14.02.2008 “Për ankandin publik”, duke qenë se jemi në kushtet e nenit 109 të Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 për “Menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, **hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë** (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillesare, groposur ose djegur, bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullat e përgjithshme të ankandit publik jemi në kushtet e realizimit të procedurës shitje me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

Bashkëngjitur me njoftimin do të jenë edhe fotot e këtyre mallrave/pajisjeve.

Kriteret e vlerësimit: Oferta me çmimin më të lartë.

Afati i dorëzimit të ofertave ekonomike pranë sekretarisë do të jetë 20 ditë, pra data 04.05.2022, pranë sekretarisë së ASCAP me adresë : Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë.



Lista e mallarave/pajisve që janë propozuar për tu nxjerr jashtë përdorimit janë:

Nr	Emërtimi mallit	Njësia	Sasia
1	Tavolina pune ngjyrë kafe të vjetra	copë	2
2	Tavolina pune ngjyrë kafe të vjetra	copë	10
3	Tavolina pune ngjyrë kafe të vjetra	copë	1
4	Tavolina pune ngjyrë kafe të vjetra	copë	1
5	Tavolina pune ngjyrë kafe të vjetra	copë	1
6	Tavolina pune ngjyrë kafe të vjetra	copë	1
7	Dollap të vjetër	copë	2
8	Dollap të vjetër	copë	2
9	Dollap të vjetër	copë	1
10	Dollap të vjetër	copë	1
11	Karrige blu statike të vjetra	copë	3
12	Karrige blu statike të vjetra	copë	2
13	Karrige kashte të vjetra	copë	3
14	Karrige kashte të vjetra	copë	1
15	Karrige rrotulluese blu të vjetra	copë	2
	TOTALI		33

1. KRITERET PËR PJESËMARRJE, KUALIFIKIM DHE VLERESIM TE OFERTES

Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

- a) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për statusin aktiv;
- b) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- c) ne rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e te cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Kandidatët Blerës duhet të plotësojnë dhe të paraqesin pranë Autoritetit Shitës kërkesat për kualifikim dhe vërtetimet si më poshtë:

- a) Ekstrakti i Rregjistrimit Tregtar mbi të dhënat e subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, duhet të ketë të përcaktuar statusin aktiv të subjektit.
- b) Dokument identifikimi të administratorit (përfaqësuesit ligjor) të shoqërisë për pjesëmarrje në ankand.
Në mungesë të administratorit të shoqërisë për pjesëmarrje në ankand, autorizimi me prokurë të posaçme i personit që do të marrë pjesë në ankand, shoqëruar me dokument

identifikimi origjinal të personit të autorizuar, një kopje e te cilit depozitohet pranë komisionit te ankandit.

- c) Dokument lëshuar nga administrata tatimore që vërteton se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.
- d) Vetdeklarim për gjendjen gjyqësor, i cili deklaron se kandidati blerës nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Afati i realizimit të kontratës:

Afati i realizimit të kontratës të jetë **2 (dy) ditë kalendarike nga momenti i nënshkrimit të kontratës.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Ngarkimi dhe transporti i objektit të ankandit do të bëhet me mjetet e kandidatit blerës.